PA1.nr.252/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.A., nga fshati ..., komuna e ..., për shkak të veprës penale "Sulm seksual " nga neni 232 par.2 nën par 2.1 lidhur me par .1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, P.nr.826/2015, datë 20.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 04.04.2018, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit L.A., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.826/2015, datë 20.02.2018, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.826/2015, datë 20.02.2018 të akuzuarin L.A. për shkak të veprës penale Sulm seksual, nga neni 232 par.2 nën par 2.1 lidhur me par .1 (KPRK)-së, e ka shpallë fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me gjobë në shumë prej 5000 (pesë mijë euro) €, të cilin dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë brenda këtij afati të caktuar me ligj, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 (njëzet) €, të paguara do ti llogaritet 1 (një) ditë burg. Është i obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shpenzimet e shkaktuara të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë euro) €, kurse në emër të kompensimit të viktimave të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë euro) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregull juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari L.A., atë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën dhe të ndryshohet vendimi i Gjykatës së shkallës së parë ashtu që ti ulet dënimi me gjobë, kurse pjesa tjetër e dispozitivit të mbetet e pa ndryshuar.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.264/2018, datë 15.03.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit L.A., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, P.nr.826/2015 të datës 20.02.2018, ndërsa aktgjykimi i ankimuar vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk animohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm te të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

I akuzuari e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi dënimin që i është shqiptuar, duke pretenduar se Gjykata e shkallës së parë gjatë shqiptimit të dënimit nuk i ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat shkojnë në favor të të akuzuarit, konkretisht rrethanat posaçërisht lehtësuese në bazë të nenit 73 par 1.2 dhe 3 të KPRK-së siç janë : sjellja e cila ka qenë në nivel të duhur para dhe pas kryerjes së veprës penale, bashkëpunimi i tije me organet e drejtësisë, rrethanat personale të kryerësit si dhe faktin se e ka pranuar fajësinë, ka ndje keqardhje, është penduar për veprën e kryer si dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej asnjë vepër penale të tillë ose të ngjashme. Gjithashtu ai ka përmendur edhe gjendjen e tij jo të mirë ekonomike, jeton me familjen e tije, është mbajtës i familjes andaj shqiptimi dhe ekzekutimi i një dënimi aq të lartë në aspektin financiar, do të cenonte edhe mjetet elementare të jetesës së kësaj familje, duke pas parasysh se i akuzuari personalisht realizon të ardhura të ulëta, dhe kontribuon në mbajtjen e familjes së tije. Dhe duke cekur të gjitha këto i akuzuari në ankesën e tij kërkon nga Gjykata e Apelit që ti shqiptoj një dënim më të ulët me gjobë, kurse pjesa tjetër e dispozitivit të mbetet e pa ndryshuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të akuzuarit për një dënim më të ulët me gjobë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka

vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 76 të KPRK-së. Si rrethana posaçërisht lehtësuese mbi bazën e së cilës gjykata ka zbatuar dënimin ndaj të akuzuarit ka marrë faktin se i akuzuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorin, që në fazat e para të procedurës penal, për veprën penale e cila i vihet në barrë, bashkëpunimin me policinë, prokurorinë dhe gjykatën , sinqeritetin tije gjatë gjykimit, dhe ndjen shumë keqardhje për rastin, sjelljen e tij pas këtij rasti, si dhe premtimin e tije qe asnjëherë nuk do të kryen një vepër të tillë penale apo tjetër, faktin se tani ka rregulluar edhe dokumentacionin e Gjermanisë ku edhe është martuar, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, dhe gjendjen e tij jo të mirë ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata gjeti dhe mori shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penalo-juridike. Me meqenëse në ankesën e të akuzuarit nuk përmendet ndonjë rrethanë e re lehtësueses e cila do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë është meritor dhe është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale te të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga kjo gjykatë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.252/18, datë 04.04.2018

Zyrtari ligjor — Kryetari i kolegjit
Bujar Ahmeti — Hashim Çollaku

Anëtaret e kolegjit:
Ferit Osmani
Gani Zabeli